



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:284555

Datë: 16.04.2024

Numri i dokumentit: 05577847

Ac.nr.8811/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Frosina Sylejmani dhe Fatmir Baloku - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve H..... M....., G.....B....., G..... B..... dhe F..... M....., të gjithë nga Komuna e Klinës, të cilët sipas autorizimit përfaqësohen nga avokatët F..... G..... dhe K..... F....., nga Prishtina me adresë Rr.“Fehmi Agani”, nr.25/4, kundër të paditurës Komuna e Klinës– Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti, Pagesa e shpenzimeve të udhëtimit dhe pagesa e shujtave ditore, vlera e kontestit 7,885.60, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.955/21 të datës 22.11.2022 në seancën e kolegjit të mbajtur më 16.04.2024 nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Klinës– Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.955/21, i datës 22.11.2022, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m i**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.955/21 të datës 22.11.2022 në pikën e parë të dispozitivit e ka aprovuar të bazuar kërkesëpadinë e paditësve H..... M....., G..... B....., G..... B..... dhe F..... M....., nga Komuna e Klinës. Në pikën e dytë të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Komuna e Klinës – Drejtoria e Arsimit, që paditëses H..... M....., në emër të kompensimit për ushqim - shujtave gjatë ditëve të punës, për periudhën kohore nga data 14.09.2020 e deri me datë 02.07.2021, gjithsejtë për 180 ditë pune t’ia paguaj shumën prej 360 euro, ndërsa për periudhën 27.09.2021 deri më datë 24.06.2022, gjithsejtë për 182 ditë pune t’ia paguaj shumën prej 364 apo shumën e përgjithshme 724.00 euro, si dhe në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit shumën prej 1,871.10 euro, për periudhën kohore nga

data 18.04.2017 deri me datën 24.06.2022, gjithsejtë për 891 ditë pune. Padi tësit G..... B....., në emër të kompensimit për ushqim - shujtave gjatë ditëve të punës, për periudhën nga data 14.09.2020 e deri me datë 02.07.2021, gjithsejtë për 180 ditë pune t'ia paguaj shumën prej 360 euro, ndërsa për periudhën 27.09.2021 deri më datë 24.06.2022, gjithsejtë për 182 ditë pune t'ia paguaj shumën prej 364 euro apo shumën e përgjithshme 724.00 euro si dhe në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit shumën prej 1,247.40 euro, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datën 24.06.2022, gjithsejtë për 891 ditë pune. Padi tësit G..... B....., në emër të kompensimit për ushqim - shujtave gjatë ditëve të punës për periudhën nga data 14.09.2020 e deri me datë 02.07.2021, gjithsejtë për 180 ditë pune t'ia paguaj shumën prej 360 euro, ndërsa për periudhën 27.09.2021 deri më datë 24.06.2022, gjithsejtë për 182 ditë pune t'ia paguaj shumën prej 364 euro apo shumën e përgjithshme 724.00 euro, si dhe në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit shumën prej 1,871.10 euro, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datën 24.06.2022, gjithsejtë për 891 ditë pune. Padi tëses F..... M....., në emër të kompensimit për ushqim - shujtave gjatë ditëve të punës, për periudhën nga data 14.09.2020 e deri me datë 02.07.2021, gjithsejtë për 180 ditë pune t'ia paguaj shumën prej 360 euro, ndërsa për periudhën 27.09.2021 deri më datë 24.06.2022, gjithsejtë për 182 ditë pune t'ia paguaj shumën prej 364 euro apo shumën e përgjithshme 724.00 euro. Respektivisht të gjitha shumat e lart cekura me kamatë ligjore, në lartësi prej 8 % në vit, duke filluar llogaritja e kamatës nga data 17.12.2021, dita e paraqitjes së padisë dhe kërkesëpadisë, në këtë gjykatë, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e këtë nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim. Në pikën e tretë të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që padi tësve t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës, dhe atë, për padi shumën prej 312.00 euro dhe për taksën gjyqësore për padi shumën prej 21.00 euro, apo shumën e përgjithshme prej 333.00 euro të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga marrja-pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur e paditura për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta prish aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar duke refuzuar në tërësi si të pa themeltë kërkesëpadinë e padi tësve apo çështjen ta kthejë në shkallën e parë për rigjykim dhe rivendosje.

Padi tësit kanë ushtruar përgjegje në ankesë duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet ankimore të të paditurës me propozimin që gjykata e apelit ta refuzojë ankesën si të pa themeltë, ndërsa aktgjykim e atakuar ta vërtetojë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të të njëjtave, e në kuptim të nenit 194, 195 dhe 200 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se padi tësit, H..... M....., G..... B....., G..... B..... dhe F..... M....., të gjithë nga Komuna e Klinës, përmes përfaqësuesve me autizim avokatët F..... G..... dhe K..... F....., me datë 17.12.2021, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e

Klinës-Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa me datë 01.08.2022, kanë precizuar kërkesëpadinë për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit dhe pagesën për shujta ditore. Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, sepse sipas të paditurës kërkesat e paditësve në këtë rast, nuk janë paraparë me Ligjin e Punës dhe se e paditura gjatë përgatitjes së buxhetit vjetor, nuk e ka paraparë në skemën e saj buxhetore linjë të veçantë për këto kompensime. Me propozim për gjykatën që kërkesëpadinë e paditësve, ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë dhe precizimit të saj, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, dhe precizimit të saj, pas administrimit të provave si dhe përgjigjes në padi, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë theksoi se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura. Nga vërtetimit me numër 94/2021 të lëshuar nga e paditura me datë datës 13.10.2021 vërtetohet se paditëja H..... M....., nga data 14.09.2020 deri me datën 02.07.2021, ka realizuar gjithsejtë 180 ditë pune për të cilat kërkon kompensimin e ushqimit dhe 709 ditë pune për të cilat kërkon kompensim për udhëtim ndërsa me vërtetimin numër 128/2022 të datës 18.07.2022, vërtetohet se paditësja nga data 27.09.2021 gjerë me datën 24.06.2022, ka gjithsejtë 182 ditë pune për kompensim për ushqim dhe për udhëtim, ndërsa me vërtetimin e lëshuar nga Agjensioni “Xh... T...” me datë 13.10.2021, vërtetohet se paditësja udhëton çdo ditë pune në relacionin Jashanicë e Ulët-Jashanicë e Lartë. Nga vërtetimin me numër 106/2021, i lëshuar nga e paditura me datë 13.10.2021 për paditësin G.....B....., vërtetohet se paditësi nga data 14.09.2020 e gjerë me datën 02.07.2021, ka realizuar gjithsejtë 180 ditë pune për të cilat kërkon kompensimin e ushqimit dhe 709 ditë pune për të cilat kërkon kompensim për udhëtim ndërsa me vërtetimin me numër 127/2022 të datës 18.07.2022, vërtetohet se paditësi nga data 27.09.2021 deri me datën 24.06.2022, ka gjithsejtë 182 ditë pune për kompensim për ushqim dhe për udhëtim, ndërsa me vërtetimin e lëshuar nga Agjensioni “Xh.... T.....”, me datë 13.10.2021, vërtetohet se paditësi udhëton çdo ditë pune në relacionin Gj..... i M....-J..... e Lartë. Nga vërtetimi numër 105/2021, i lëshuar nga e paditura me datë 13.10.2021 për paditësin G..... B....., vërtetohet se paditësi nga data 14.09.2020 deri me datën 02.07.2021, ka realizuar gjithsejtë 180 ditë pune për të cilat kërkon kompensimin e ushqimit dhe 709 ditë pune për të cilat kërkon kompensim për udhëtim ndërsa me vërtetimin me numër 125/2022 të lëshuar nga e paditura me datë 18.07.2022, vërtetohet se paditësi nga data 27.09.2021 gjerë me datën 24.06.2022, ka gjithsejtë 182 ditë pune për kompensim për ushqim dhe për udhëtim dhe me vërtetimin e lëshuar nga Agjensioni “Xh..... T.....”, me datë 13.10.2021, vërtetohet se paditësi udhëton çdo ditë pune në relacionin

Gjurgjevik i Madh-Jashanicë e Lartë. Nga vendimi me numër 130/2021 të lëshuar nga e paditura me datë 18.10.202 për paditësen F..... M....., vërtetohet se e njëjta nga data 14.09.2020 e deri me datën 02.07.2021, ka realizuar gjithsejtë 180 ditë pune për të cilat kërkon kompensimin e ushqimit ndërsa me vërtetimin numër 122/2022 të datës 18.07.2022, vërtetohet se paditësja nga data 27.09.2021 deri me datën 24.06.2022, ka gjithsejtë 182 ditë pune për kompensim për ushqim. Andaj, gjykata e aprovoi si të themeltë kërkesëpadinë e paditësit duke e mbështetur vendimin e saj në nenin 35 paragrafi 5 dhe 7 të Kantatës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Për sa i përket llogaritjes së kamatës ligjore, gjykata vendosi sipas nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës vendimin e mori bazuar në nenin 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Aktgjykimi i atakuar me ankesë është i rregullt në pikëpamje të strukturës dhe përmbajtjes duke përfaqësuar kështu një vendim i cili është koherent në pikëpamje logjike dhe juridike duke eliminuar çfarëdo kontradikte për ta kualifikuar si kundërthënës. Mënyra e zhvillimit të procedurës dhe e hartimit të vendimit nga gjykata e shkallës së parë kanë garantuar një proces të drejtë dhe të paanshëm duke u mbështetur për përfundimin e saj në themelin faktik dhe juridik të çështjes.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pa bazuara pretendimet ankimore e të paditurës për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor.

Gjykata e Apelit, analizoi dhe vlerësoi me kujdes pretendimin ankimor të palës së paditur e cila në ankesë ka theksuar se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së Aktgjykimit ankimor ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si pasojë e shkeljeve procedurale të nenit 398 të LPK-së për faktin se nuk ka hapur fare shqyrtim lidhur me prapësimin e të paditurës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të atakuar gjeti një pretendim i tillë është i pabazuar.

Në rastin konkret, nga shkesat e lëndës konstatohet se paditësit e kanë ushtruar padinë me datë 17.12.2021 me të cilën kanë kërkuar që të obligohet e paditura ti kompensojë paditësit për shpenzimet e ushqimit-shujtës ditore dhe për shpenzimet e udhëtimit. Nga interpretimi i nenit 398 të LPK-së del se në qoftë se, pas marrjes së përgjigjes në padi, gjykata konstaton se, ndërmjet palëve kontestohen faktet relevante, ajo do të caktojë seancat gjyqësore për vërtetimin e tyre, mirëpo, nëse konstaton se, ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator gjykata mund të japë aktgjykim me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë. Fjala “mundet” e përdorur në këtë dispozitë e lë në diskrecionin e gjykatës dhënien e aktgjykimit të tillë, mirëpo, meqenëse ligjdhënësi me këtë zgjidhje ligjore ka synuar që në rastet kur gjendja faktike është e qartë dhe jo kontestuese ndërmjet palëve, procedura gjyqësore duhet të përfundojë në afatin sa më të shkurtër dhe me sa më pak shpenzime, rezulton se gjykatat do të duhej që të jepnin aktgjykimin pa procedim të mëtejshëm, sa herë që plotësohen kushtet e parapara me këtë dispozitë. Në këtë rast aktgjykimi ankimor nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga nenit 182 paragrafi 2 pika n) për faktin se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar i ka dhënë arsyet lidhur me prapësimin e të paditurës për parashkrimin e kërkesës në këtë çështje kontestimore të cilat arsye Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i pranon si të drejta dhe ligjore.

Gjykata e Apelit i refuzon si të pabazuara pretendimet ankimore të palës së paditur e cila në ankesë thekson se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk është obligative për të paditurën, për arsye se nuk është nënshkruar nga Komuna e Klinës si autoritet i veçantë si rrjedhë Komuna e Klinës nuk ka legjitimitet në raport me kërkesëpadinë e paditësve, po ashtu se nuk janë përmbushur kushtet e parapara me nenin 46 të kësaj Kontrate, meqenëse nënshkruesit e kësaj kontrate siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare. Gjykata e Apelit konsideron se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedhë se obligimi për përmbushjen e të drejtave të punësuarve të parapara me këtë kontratë, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura dhe në këtë pikëpamje e paditura gëzon legjitimitet të plotë për të qenë palë në procedurë dhe çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësve, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Në rastin konkret është obligim i të gjitha institucionet edukativo arsimore publike dhe private të zbatojnë këtë kontratë, pasi që e njëjta është nënshkruar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK-ut, prej së cilës rrjedhin detyrime të cilat është e obliguar e paditura t'i përmbush, gjegjësisht përgjegjësia për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe të drejtat tjera të cilat u përkasin punonjësve të arsimit ku sipas nenit 2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë është përcaktuar zbatimi i kësaj kontratë *“1. Për të drejtat dhe obligimet që nuk janë përfshirë në këtë Kontratë, zbatohet legjislacioni në fuqi dhe Kontrata kolektive e përgjithshme. 1.1. Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Para universitar*

*(parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK - ut. 1.2. Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat- DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT - in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo - arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.*

Prandaj, thëniet e të paditurës se kërkesëpadia duhet refuzuar, nga shkak se nënshkruesit e marrëveshjes nuk ia kanë siguruar të paditurit mjetet për buxhet për pagesë nuk janë të bazuara, duke marrë parasysh se ai shkak i cili do ta lironte të paditurën nga përgjegjësia, nuk është paraparë as me dispozitat e ligjit e as të Kontratës kolektive, e as përfaqësuesi i të paditurit nuk ka provuar në ndonjë mënyrë tjetër se thëniet e tij janë të bazuara.

Po ashtu, sipas Gjykatës së Apelit nuk qëndrojnë as pretendimet ankimore të palës së paditur e cila ka theksuar se paditësit nuk kanë ofruar prova të mjaftueshme për ta mbështetur kërkesëpadinë e tyre në raport me shpenzimet e udhëtimit e kjo për faktin se në shkresat e lëndës gjenden prova siç janë vërtetimet e lëshuara nga e paditura e po edhe nga vërtetimet e lëshuara nga Agjencia e Udhëtimit “ Xh..... T.....” konfirmohet se paditësit udhëtojnë për në vendin e tyre të punës e po ashtu konfirmohet edhe çmimi i itinerarit për vajtje-ardhje për në vendin e tyre të punës të cilat vërtetime gjykata e shkallës së parë me të drejtë ia fali besimin ngase sipas nenit 329 paragrafi 1 të LPK-së “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të” dhe bazuar në nenin 329 paragrafi 2 të LPK-së “ Të njëjtën fuqi provuese e kanë edhe shkresat tjera të cilat, me dispozita të veçanta, në pikëpamje të fuqisë provuese janë barazuar me shkresat publike”, andaj Gjykata e Apelit vlerëson se mënyra e vendosjes nga gjykata e shkallës në raport me shpenzimet e udhëtimit është i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësve që në emër të kompensimit të ushqimit për ditët e pranisë në punë dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit t’ia kompensojë shumat e aprovuara si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Gjithashtu edhe për lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në mënyrë të ligjshme, pasi që në shkresat e lëndës ka pasur prova të mjaftueshme siç janë vërtetimet lidhur me ditët e pranisë në punë dhe vërtetimet lidhur me çmimet e biletave për udhëtimit në relacionet ku paditësit kanë udhëtuar, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjithashtu, edhe vendosja lidhur me kamatëvonesën, është në përputhje të plotë me nenin 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton detyrimin e debitorit në pagesën e kamatëvonesës si pasojë e vonesës në përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit, e në rastin konkret e paditura meqë, është vonuar dhe nuk ka përmbushë detyrimin e saj ndaj kreditorit në afatin e përcaktuar me kontratë kolektive, atëherë e njëjta i detyrohet në përmbushjen e detyrimit së bashku me kamatëvonesën në shkallë prej 8% vjetore.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat neni e 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifatat për shpenzime gjyqësore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të paditurës, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr.8811/2022, datë 16.04.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,  
Ardian Ajvazi